



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ prot

Gramsh, më 30/04/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 30.04.2021

Për: BOE - “Viante Konstruksion” sh.p.k & “Euro-Alb” sh.p.k & “Llazo” sh.p.k

Adresa: Lagjia “Sporti “ Gramsh, Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë & Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, zona kadastrale 1197, nr pasurie 3/21, Fier

Procedura e prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-88835-03-02-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike 08/03/2021 [Nr. 34]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

* * *

1. **BOE - “Bajrami N” sh.pk & “Rafin Company” sh.p.k**, me nr.Nipti K0272702O & L52125110A me vlerë të ofertës 68 446 765 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e katërqind e dyzetë e gjashtëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, pa TVSH.
2. **BOE- “Viante Konstruksion” sh.p.k & “Euro-Alb” sh.p.k & “Llazo” sh.p.k**, me nr.Nipti K47103804L & K66613407H & K24218401K me vlerë të ofertës 80 829 815 (tetëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë – “Bajrami N” sh.pk & “Rafin Company” sh.p.k, për arsyet :

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky BOE **nuk** ka dorezuar ne SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST, si më poshtë:

- -Në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” , pika 8 “ Certifikatat e cilësisë”, gërmat a, b , c, d, f, g në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatat e cilesise ISO dhe Kataloget perkates te produkteve për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: Inerte, – Betone, Hekur, Materialet Elektrike, Bordura betoni, puseta betoni, tuba betoni, pllaka trotuari betoni etj. Materialet hidraulike - tubo, rakorderi, Materiale te Gjelberimit.

- Në përmbushje të këtyre kriterëve BOE ka dorëzuar kontratën e furnizimit për hekur nr.1983 Rep, 755 kol datë 12.04.2021, dhe bashkëngjitur certifikatat e cilësive ISO 9001-2015, shoqëruar me certifikatat e konformitetit/performances sipas EN 10080:2005, **në gjuhë të huaj**, gjithashtu nuk ka dorëzuar certifikatat HRN 1130-2:2008, TS 708:2010 sic kërkohet në DST.
- Ka dorëzuar kontratën e furnizimit datë 09.04.2021 ndërmjet shoqërisë “A BI ESSE” shpk dhe “Bajrami N” shpk , *pa përcaktuar objektin dhe materialet që do të furnizohet* , pasi nuk ka dorëzuar shtojcën 1 sic shprehet kontrata, kontrata është pa firmën dhe vulën e të furnizuarit “Bajrami N” shpk, po ashtu certifikatat e cilësisë dhe katalogët **janë në gjuhë të huaj**.
- Ka dorëzuar kontratën e furnizimit për Bordura betoni, puseta betoni, tuba betoni, pllaka trotuari betoni etj nr.1986 rep, nr.758 kol datë 12.04.2021 por nuk ka dorëzuar certifikatat ISO 39001:2012 dhe ISO 45001:2018.
- BOE ka dorëzuar kontratën e furnizimit për Materialet hidraulike - tubo, rakorderi, nr. 1953 Rep, nr.736 kol, datë 09.04.2021 , por certifikatat e cilësisë ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 , **janë në gjuhë të huaj**.
- Në nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: *“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”*
- Në shtojcën nr. 12/1, “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të licënsuar dhe të noterizuar në gjuhën shqipe”*.
- Ndërsa në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.6 është përcaktuar shprehimisht: 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip x Anglisht Tjetër _____.
- Në seksionin II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë”ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*,
- Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*
- -BOE nuk ka dorëzuar Licence III.7.A "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore baze", - për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - Materiale te Gjelberimit, në kundërshtim me pikën 8/g të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- -Anëtari "Rafin Company" shpk sipas akt marrëveshjes nr. 1998 rep , nr.766 kol datë 12.04.2021 ka marrë përsipër të kryejë punime për "mure mbajtës betoni" dhe "mure pritës betoni" , ndërkohë nuk ka paraqitur kontrata furnizimi për hekur.
- - BOE nuk përmbush kriterin për 4 copë-Kamionë (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion.Vetëm kamionat me targa AA042EN dhe AA208NE , kanë kapacitetin mbajtës të kërkuar. Kamioni me traga AA049ML nuk është deklaruar tek shtojca e mjeteve.

- BOE nuk përmbush kriterin për 2 copë Kamionçina (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë.Vetëm kamioncina me targa AA961FP , ka kapacietin mbajtës të kërkuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë -BOE –“Viante Konstruksion” sh.p.k & “Euro-Alb” sh.p.k &“Llazo” sh.p.k** , me adresë Lagjia “Sporti “ Gramsh, Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë & Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, zona kadastrale 1197, nr pasurie 3/21, Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **80 829 815 (tetëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë)lekë,pa TVSH**, pikët totale të marra [____],është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”,Sheshi “Kamber Dërmyshi “ ,pranë Njesisë së Prokurimit,kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [____], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.04.2021.

Ankesa:Nuk ka patur ankesa

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**KRYETARI
KLODIAN TAÇE**

Konceptoi: E.Guzi

Miratoi: E.Guzi

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____